VENDIM
Nr. 140, datë 15.8.2016

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "GAVRAN ENERGY" SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et "GAVRAN 1", ME FUQI TË INSTALUAR 998 KW DHE "GAVRAN", ME FUQI TË INSTALUAR 1215 KW, ME FUQI TOTALE TË INSTALUAR 2213 KW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 21 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.8.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Gavran Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Gavran Energy" sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Gavran Energy" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Gavran 1", me fuqi 998 KW dhe "Gavran", me fuqi 1215 KW, me fuqi totale të instaluar 2213 KW, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti